



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURES
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 484 Prot.

Tiranë, më 23.04 2018

VENDIM Nr. 60, datë 20.03.2018

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.4, datë 20.03.2018, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Zgërdheshi : Transformimi i një qyteti ilir gjatë antikitetit të vonë dhe mesjetës" 2018*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), drejtuese Dr. Elvana Metalla dhe Dr. Thomas Mayrer nga Universiteti Goethe Frankfurt, Gjermani, paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Zgërdheshi : Transformimi i një qyteti ilir gjatë antikitetit të vonë dhe mesjetës" 2018*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), drejtuese Dr. Elvana Metalla dhe Dr. Thomas Mayrer nga Universiteti Goethe Frankfurt, Gjermani, paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Dokumentimi (tachymetric) i strukturave të ruajtura të ndërtimit
 - Dokumentimi (vizatime dhe fotogrametri)
 - Prospektimi gjeofizik (gjeoradar)
 - Sondazhe gërmimi në strukturën rrethore Rotonda, në platformën e qytetit "Exedra", në qytetin e poshtëm
 - Pastrime nga vegjetacioni i kishës dhe varrezës
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë ajo e nevojshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2018.

3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO EURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al